



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1279 prot

Shkodër, më 27.03.2025

VENDIM

Nr 105 datë 27.03.2025

"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGESËS MË HONORARE, TË PERSONALITETEVE VENDASE OSE TË HUAJA, NGA KATEGORIA "AKADEMIK" DHE NGA KATEGORIA "PROFESOR", PËR PJESËMARRJEN NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, gërma c); neni 62; Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 5, pika 3, gërma c); neni 17, pika 6, gërma ç); neni 44; Pika 9, e VKM- së me nr.748, datë 11.6.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë" (i ndryshuar). Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27.03. 2025.

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagesës me honorare të personelit akademik të ftuar në cilësinë e personaliteteve vendase ose të huaja nga kategoria "Akademik" dhe nga kategoria "Profesor", për pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Masa e pagesës me honorarë për ditë/ orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në institucionet publike të arsimit të lartë, të jetë sa 3-fishi i pagesës për orët mbi normë, për kategorinë "Profesor".
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre pagesave përballohen nga të ardhurat e veta të USH-së.
4. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Tonin Gjuraq

